

STATUTI

(I SHOQERISE ME PERGJEGJSI TE KUFIZUAR) “BUNA TRAVEL” sh.p.k

Duke u bazuar ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ne ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per qendren kombettare te regjistrimit, sot me date 03.02.2015 Ortaket:

1. **Muhamet Shyqyri Naziri** lindur me 01.01.1965 banuese ne qytetin Shkoder me karte Identiteti nr. G50101191E
2. **Dritan Shyqyri Neziri** lindur me 16.03.0976 banues ne Oblike me Karte Identiteti nr.H60316108L
Me vullnetin e lire hartojne statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “BUNA TRAVEL” sh.p.k

Neni 1

Forma e shoqerise

Kjo shoqeri do te jete “Shoqeri Tregtare” e formes “Shoqeri me pergjegjsi te kufizuar” (sh.p.k.)

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe ate tregtar, civil, doganor, tatimor, fiskal si dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtrimin e saj sipas objektit te veprimtarise se saj, mbi bazen e Aktit – themelimit dhe te drejtes nderkombetare

Kjo Shoqeri do te quhet: “BUNA TRAVEL” sh.p.k.

Neni 2

Vula dhe simboli i shoqerise

Shoqeria ka vulën dhe simbolin e saj e cila ka formë drejtkendeshe, përmbajtja e të cilës është: “Në rreshtin e pare shkruhet (lart) “BUNA TRAVEL” sh.p.k , ne qender (NIPTI) (poshte rreshti i trete) SHKODËR ALBANIA

Neni 3

Objekti i veprimtarise

Shoqeria “BUNA TRAVEL” shpk perfaqson: Bashkimin e shume veprimtarive ekonomike ne nje qender te vetme biznesi te cilet kan objekt veprimtarite si me poshte:

- ☞ Agjensive transport udhetaresh dhe me taksi brenda e jashte vendit
- ☞ Transport udhetaresh me autobuz si transportet e rastit dhe ne linje te rregullta qytetese, rrethqytetese, nderqytetese brenda dhe ndermjet qarqeve, si dhe nderkombetare
- ☞ Agjenci spedicionere per transport mallrash
- ☞ Agjensi turistike - biletari dhe akomodim te grupeve turistike
- ☞ Hapje te lokaleve ne vendet turistike dhe te banuara per Bar - Restorante dhe Hotele
- ☞ Transport turistik ne rruge toksore, ujore dhe ajrore brenda dhe jashte vendit
- ☞ Tregtim te produkteve industriale dhe bujqesore, paisjeve te gjitha llojeve elektroshtepiake, konfeksioneve e te veshmbathjeve, kancelari e kozmetike
- ☞ Prodhim e tregtim import - eksport dyer e dritare druri dhe duralumini si dhe tregtim mobile
- ☞ Prodhimin dhe tregtimin e pijeve freskuese dhe alkoolike.
- ☞ Grumbullim dhe tregtim brenda e jashte vendit te bimeve mjeksore dhe eterovajore
- ☞ Mabrshtrim te gjitha llojeve te blektorise ne natyre dhe me rregjim stallor, per prodhim mishi dhe qumeshti, perpunimin dhe tregtimin brenda e jashte vendit te produkteve e nenprodukteve te tyre

- ☞ Prodhimin e tregtimin te gjitha materiale qe sherbejne ne fushen e ndertimeve, duke perfshire materialet elektrik. Prodhime brumra ,furre buke

Neni 4 Selia e shoqerise

Shoqeri "BUNA TRAVEL" shpk ka selinë e vet në qytetin Shkodër. Adresa: Lagje "Qemal Stafa", Rruga "13 dhjetori" ish pallati Kinezve Hyrja I kati IV
Adresa e mailit: tanneziri@gmail.com. Shoqeria ka te drejte te hape filjale kudo ne Shqiperi dhe jashte saj.

Neni 5. Kohezgjatja

Kohezgjatja e kesaj Shoqerije do te jete pa afat.

Me vendim te asamblese se pergjithshme (te ortakeve) kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise mund te ndryshoje dhe ky vendim dergohet menjehere per depozitim ne Q.K.R.

Neni 6. Kapitali themeltar

Kapitali I shoqerise me pergjegjisi te kufizuar "BUNA TRAVEL" shpk eshte autobuzi me targe SH 9058 E me vleren 1 000 000 (njemilion) lek. ne natyre I ndare ne dy kuota

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:
Ortakët Themelues:

- | | | | | |
|-------------------|---------------------|--------------|----------------------------|-----|
| 1. Muhamet Neziri | Vlera e kontributit | 510 000 lek. | Zoteron kuoten e kapitalit | 51% |
| 2. Dritan Neziri | " " | 490 000 lek | " " | 49% |

Neni 7.

Asambleja e ortakev ka te drejte te transferoje jashte teritorit te republikes se Shqiperise, pjeserisht ose teresish kontributet e saj, perfshire dhe fondet dhe kontributet ne natyre.

Transferimet e kapitalit themeltar duhen te jene te vertetuara me akt noterial dhe per nje gje te tille asambleja e pergjithshme duhet te marre paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo tu behen te ditur.

Neni 8

1. Kapitali themeltar mund te rritet ose ta zvogelohet pa limit, në çdo çast, një ose disa herë, në zbatim te statutit te shoqerise.
2. Kontributet e reja për rritjen e kapitalit të shoqërisë mund të konsistojnë në para ose pasuri dhe të drejta të vlerësueshme në para. Ai rritet apo zvogelohet proporcionalisht pa ndryshuar kuotat e perfaqsimit te aksioneve. Kontributet e aksionareve nuk mund të jenë me punë apo shërbime.

Neni 9

1. Kuotat e kapitalit të shoqërie e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
 3. Pjeset e kapitalit mund të transferohen te trefteve teresisht ose pjeserisht nepermjet shitjes ose dhurimit te kuotave, por ne cdo rast duke ju afruar me pare ortakevete tjere.

Neni 10 **Organet e shoqerise**

1. Asambleja e pergjithshme e ortakeve
2. Administratori

Asambleja mund ti delegoje kopetencat nje ose me shume administratoreve te emeruar prej saj, ose dhe te nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise me vendim te ortakeve mbi bazen e procedurave

Neni 11

Me vendim te asamblese se pergjithshme shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere shtetas Shqiptar ose te huaj ose te bashkohet me nje shoqeri tjetër brenda dhe jashte vendit

Neni 12 **Asambleja e pergjithshme dhe kopetencat e saj**

1. Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Ajo ushtron te gjitha kopetencat qe i njuh ligji "Per shoqerite tregtare"
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të zakonshme për çështjet e mëposhtme:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - c. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proceset gjyqësore ndaj administratorit;
 - d. çdo çështje tjetër, të përcaktuar nga ligji apo statuti.:
 - e. ndryshimin apo plotësimin e statutit të shoqërisë;
 - f. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - g. riinvestimin e fitimeve vjetore;
 - h. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - i. ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksionet e kategorive të ndryshme;
 - j. riorganizimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo
 - k. likuidimin e shoqërisë, si edhe riorganizimin e shoqërisë në një formë tjetër;

Neni 13 **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret dhe drejtohet nga administrator
2. Asambleja e Përgjithshme thirret sa herë që të jetë e nevojshme, për interesat e shoqërisë ose, në rast se kërkohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit qershor të çdo viti, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor.

4. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

5. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 4 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

6. Rendi i ditës përmban vendimet e propozuara për çdo çështje, për të cilën Asambleja e përgjithshme merr një vendim.

7. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë vendime, që kanë të bëjnë me projektpropozimet për ndryshime në statut, i përfshin si çështje të rendit të ditës këto projekt propozime

8. Asambleja e Përgjithshme nuk diskuton çështje, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës

9. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në një vendndodhje, të ndryshme nga selia e shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj

10. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave të pranishëm në vende të ndryshme, të lidhur nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, në përputhje me metodat e zakonshme të telekomunikimit, ku përfshihen mjetet elektronike, me kusht që të gjithë aksionarët, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës apo mjeteve të ngjashme elektronike, të identifikohen dhe atyre t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet, për të marrë pjesë drejtpërdrejt në çështjet e trajtuara dhe për të marrë, dërguar ose shqyrtuar dokumentet.

11. Secili aksionar ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht aksionar, në bazë të një prokure me shkrim. Prokura mund të jepet jo vetëm për perfaqsimin në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme por edhe për veprime të tjera juridike që kanë të bëjnë me aksionet dhe perfaqsimin e tyre pranë të gjitha organeve shtetërore dhe të pushtetit lokal e dhe është e vlefshme sipas afateve të percaktuara në prokure

Neni 14 **Administratori**

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve në mbledhjen e parë ka emëruar administrator të shoqërisë **"BUNA TRAVEL"** shpk z. **Dritan Neziri**

2. Kohezgjatja e mandatit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje

3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 **Kompetencat e administratorit**

1. Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, brenda kufijve të vendosur nga ligji, dhe kompetencat e deleguara shprehimisht nga Asamblese se përgjithshme

2. Administratori i shoqërisë merr pjesë në të gjitha mbledhjet e aksionarëve, kryen të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të Asamblese se përgjithshme.

3. Administratori ka kompetencë të përfaqësojë shoqërinë, në çdo organ shtetëror dhe të drejtësisë, të

nënshkruajë dokumentet dhe aktet që I perkasin veprimtarisë së shoqërisë, të hape dhe të administrojë llog bankare në emër të shoqërisë dhe të nënshkruajë çdo dokument, që kërkohet e vulosur me vulën e shoqërisë, përveç rasteve në të cilat kërkohet apo lejohet nga ligji që dokumentet të nënshkruhen dhe të ekzekutohen në tjetër mënyrë,

4. Administratori kryen edhe detyra të tjera, të parashikuara nga ligji, si dhe ato, të cilat i caktohen, kohë pas kohe, nga Asamblese se përgjithshme

5. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

6. Kryen regjistrimet dhe dërgonë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

7. Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

Neni 16 Kontabiliteti

Shoqëria mban llogari kontabile të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet, në mënyrë të hollësishme, gjendja e saj financiare, në përputhje me parimet e konsoliduara të kontabilitetit. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarde kontabiliteti, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17 Eksperti kontabël i autorizuar

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të jashtëm e të pavarur, të cilët janë ekspertë kontabël të autorizuar sipas ligjit.

2. Ekspertët kontabël të autorizuar kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 18 Viti financiar, pasqyrat financiare vjetore dhe ndarja e dividendëve

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

2. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, shpërndahen, si më poshtë vijon:

a) 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit;

b) Pjesa e mbetur ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ose riinvestohet në shoqëri për rritjen e kapitalit

Neni 19 Prishja, ndarja dhe bashkimi

1. Shoqëria mund të priset, si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

2. Shoqëria mund të ndahet apo të bashkohet me shoqëri të tjera me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 20
Likuidimi

1. Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.
2. Në përputhje me këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët hartojnë raportin përfundimtar për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë dhe për procedurat e kohën e duhur për likuidimin.
3. Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos për bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
4. Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, likuiduesit u shpërndajnë aktivet e mbetura aksionarëve.

Neni 21
Dispozita përfundimtare

Çështjet, që nuk parashikohen shprehimisht nga ky statut, rregullohen nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENSHKRIMI I ORTAKEVE

1. **Muhamet Neziri**



2. **Dritan Neziri**



Shkoder me 03.02.2015